

Tiranë, 7 prill 2026

ISP: KOMENTE DHE REKOMANDIME NË DRAFTIN E LIGJIT “PËR FINANCIMIN E PARTIVE POLITIKE”

Instituti i Studimeve Politike (ISP) e vlerëson pozitive nismën ligjore për të pasur një ligj të posaçëm lidhur me financimin e partive politike. Ky ka qenë një rekomandim i hershëm edhe i ISP. Financimi i partive politike është i ndërlidhur jo vetëm me konceptin e shtetit të së drejtës, por edhe me besimin publik te demokracia dhe partitë politike, si dhe me parimet e transparencës dhe llogaridhënies.

Neni 9 i Kushtetutës së RSH përcakton: *“burimet financiare të partive, si dhe shpenzimet e tyre bëhen kurdoherë publike”*. Drafti është një hap i rëndësishëm drejt zbatimit/plotësimit të përgjegjësiave të këtij neni, por nuk është hap ende i mjaftueshëm, i plotë dhe funksional.

Rekomandimi dhe kërkesa jonë ka qenë e mbetet se një ligj mbi financimin e partive politike duhet të jetë integral me ligjin e ri mbi partitë politike dhe aspektin e financimeve elektorale, të cilat Komisioni mund t’i adresojë paralelisht në Kodin Zgjedhor. Ecja paralele me tre ndryshimet mund të krijonte një paketë solide ndryshimesh dhe harmoni midis ligjeve, zgjidhje të mosmarrëveshjeve dhe keqkuptimeve, etj, kurse ecja e veçuar, pa pasur ende një draft mbi ndryshimet e tjera nuk ofron siguri se reforma e premtuar do të marrë zgjidhjen që meriton një vend kandidat potencial për anëtarësim në Bashkimin Europian.

Duke presupozuar se Komisioni dhe grup teknik e ka tashmë, ne mendojmë se do të kishte qenë më efektive nëse për çështjet thelbësore të ligjit, praktikën e mira, reflektimin e rekomandimeve të ODIHR, GRECO, vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, opinionet e Komisionit të Venecias, etj, të kishte pasur një analizë profesionale të problematikës përpara se të kalohej në draft.

- Gjithashtu, një dokument i thelluar vlerësimi nga ana e KQZ do të kishte qenë ndihmues, sidomos edhe për shkak se KQZ është konsideruar në ligj si institucioni i vetëm që forcohet dhe ngarkohet me përgjegjësi të reja.
- Një opinion paraprak për problematikën respektive duhej të kishte edhe nga **audituesit**, bazuar në përvojat dhe kapacitetet e tyre, nga **SPAK** në hetimet mbi krimet zgjedhore, nga **DPPPP, DPTT, KLSH, ILDKPKI**, etj, për gjetjet dhe opinionet e tyre, si dhe nga institucionet e tjera të përfshira në ligj.

- Gjithashtu do të kishte qenë plotësuese e rëndësishme edhe listimi paraprakisht nga komisioni i rekomandimeve të ardhura (nëse ka) nga partitë parlamentare dhe komisionet e mëparshme për reformën.

Ndërtimi i një roadmap mbi strukturën e reformës së plotë (Kodi Zgjedhor, ligji mbi financimin dhe ai mbi partitë politike, ligji mbi qeverisjen lokale dhe mbi lobimin, etj), për të krijuar panoramë më të plotë dhe evituar përsëritjet apo mbivendosjet.

Të gjitha këto dokumente mendojmë se, nëse ekzistojnë, do të duhej të ishin publike dhe pjesë e paketës së konsultimit publik. Pa to, procesi bëhet më i brishtë dhe reforma jo i plotë.

DUKE U BAZUAR NË DRAFTIN E PROPOZUAR tashmë, më poshtë renditen disa aspekte që mendojmë se duhet t'i shtoheshin ligjit:

1. **Dispozita të forta parandaluese të financimeve që vijnë nga krimi i organizuar**, si dhe mënyra sesi vepron nëse sistemi gjyqësor provon se donatori ishte pjesë e krimit të organizuar.
2. Mund të sugjerohen dispozita **lidhur me dekriminalizimin**. Subjektet që promovojnë kandidatë me rekorde kriminale duhet të kenë pasojë juridike dhe financiare.
3. **Lobimi politik**. Një nga problematikat e ndeshura është lobimi jashtë nga politikanë dhe parti politike. Do të duhej të ishte pjesë e dispozitave ligjore dhe e një mekanizmi deklarimi publik, (akses i plotë dhe në kohë i rasteve), sipas praktikës amerikane.
4. **Integrim i database dhe të dhënave midis institucioneve**. Të dhënat e KQZ, si dhe përcaktimi se krijon akses për disa institucione të tjera ligjzbatuese është i pamjaftueshëm, - e gjithë database duhet të jetë produkt ndërinstytucional dhe burim referimi/hetimi nga institucionet ligjzbatuese.
5. **Dispozita lidhur me financimet nga diaspora** dhe aktiviteti i partive atje. Praktika gjermane, kroate dhe e Kosovës do të ishte e mjaftueshme për një bazë ligjore për rregullimin e këtij burimi ende të parregulluar nga legjislacioni ynë.
6. **Të ardhurat nga media e partisë, nga fushatat, nga aktivitetet e bamirësisë, etj**, si dhe të ardhurat e provuara se janë siguruar nga burimet shtetërore, përveç penalizimit sipas Kodit, duhet të regjistrohen si pjesë e burimeve vjetore të partive kur ato bëjnë deklarimin.
7. Sugjerojmë rregullime edhe në dispozitat për rastet e **shkrirjes së partive, krijimit të ndarjeve (konflikteve të brendshme)**, apo **veprimet të koalicioneve zgjedhore** si subjekt politik.
8. Sugjerojmë përfshirjen e **kandidatëve të pavarur** në formulën e ndarjes së fondeve publike nëse kandidati kalon pragun 1% të njëjtë për subjektet.
9. Sugjerojmë një rregullim midis numrit të partive parlamentare në fillim të legjislaturës, atyre që krijohen gjatë legjislaturës dhe atyre që ekzistojnë në periudhën paraelektorale. **Lëvizja e deputetëve** nga një parti në një tjetër mendojmë se duhet të shoqërohet edhe me lëvizjen e fondeve publike për partitë, pjesa e dhënë mbi bazën e numrit të mandateve.

LIDHUR ME DRAFTIN LIGJOR, NEN PWR NEN, LUTEMI GJENI KOMENTET TONA ME REKOMANDIMET PËRKATËSE SI MË POSHTË:

- I. Neni 1: Qëllimi dhe objekti, *“rregullon mënyrën, kushtet e financimit, administrimin, transparencën, raportimin dhe kontrollin për të ardhurat dhe shpenzimet që kryejnë partitë politike në RSH”* apo siguron *“transparencën dhe përputhshmërinë e aktiviteteve financiare të partive politike me sistemin e demokracisë parlamentare”*.

Koment dhe rekomandim: Përmbajtja e ligjit nuk përputhet me qëllimin dhe objektin. Ligji ka në fokus financimin vjetor të partive politike, jo të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet, ku futen edhe ato të periudhave elektorale. Ligji nuk siguron gjithashtu transparencën e plotë, ndaj rekomandojmë të evidentohet se fokusi i ligjit janë financat e partive politike jashtë periudhave elektorale.

- II. **Neni 4:** Lidhur me përdorimin e burimeve financiare dhe materiale të partive politike.

Koment dhe rekomandim: pikat b, c, ç, d janë specifikime të detajuara të pikës a ndaj mund të evitohen. Në thelb ato janë aspekte të aktiviteteve të rregullta të partive politike. Pika c, p.sh., duket se e merr të mirëqenë që partitë kanë organizim të grave dhe të rinisë, kur jo të gjitha partitë parlamentare kanë edhe aktualisht organizime të tilla ose mund të kenë organizime të reja, si p.sh. veteranët, etj (si në shumë modele europiane). e njëjta logjikë edhe për pikën d, - jo çdo parti parlamentare që financohet ka grup parlamentar, etj. Përfundimisht pika e parë dhe e fundit do të mjaftonin për këtë nën për ta bërë atë real dhe të zbatueshëm.

- III. **Neni 4, pika 2. Burimet financiare dhe materiale të partisë politike nuk përdoren për përfitime personale.**

Koment dhe rekomandim: Çfarë nënkuptohet me konceptin “personal”? Kryetari? Financieri? Ndonjë anëtar i partisë? Është term i përgjithshëm, deklarativ dhe pa bazë identifikuese ligjore. Rekomandimi është të hiqet si pikë e tepërt. Ka parime të tjera rregullatore në ligj të mjaftueshme për këtë shqetësim.

- IV. **Neni 5. Ndalimi i ushtrimit të presionit.**

Koment dhe rekomandim: Dy pikat që lidhen me ndalimet nuk kanë mekanizma të tjerë verifikues dhe vendimmarrës përveç Kodit Penal. Ndaj janë deklarative, pa efekt dhe të paignifikueshme. P.sh., si verifikohet “premtimi i privilegjeve apo përfitimeve personale”? Cili është penalteti për raste të tilla ndalimesh?!

- V. **Neni 7. Ndalimi i ndihmave financiare dhe materiale**

Ky është një nga nenet më të rëndësishme të ligjit. Ka disa risi pozitive, specifikime të ndalimeve, sidomos “investitorë strategjikë”, personat dhe shtetet e huaja, subjektet me kontrata koncesioni, kontrata të partneritet publik privat, etj.

Komente dhe rekomandime:

- a) Tendenca për të zgjidhur me ligj disa problematika aktuale, duke futur kategori të cilat mund të ekzistojnë vetëm për një periudhë të shkurtër kohe (investitorë strategjikë, kriptomonedhat, etj, jo tregtarët e armëve, p.sh., apo kufizime kohore në disa raste deri 3 vjet, etj, duket se më shumë shprehin nevojën afatshkurtër për zgjidhjen e një problematike sesa ofrojnë një mekanizëm afatgjatë dhe të qëndrueshëm kufizimesh të matshme, të verifikueshme dhe të realizueshme.
- b) Cili institucion, p.sh., do të krijojë database për personat juridikë të huaj, investitorët strategjikë, ortakë ose aksionarë, firmat në kontrata koncesioni, kontrata të partneritet publik privat, subjektet debitorë ndaj RSH, etj, etj? Kur krijohet dhe si bëhet transparent kjo database? Kur konsiderohet ekzistenca e saj, më 1 janar deri 31 dhjetor të çdo viti apo në vazhdimësi?
- c) Elementi tjetër kufizues: organizatat joqeveritare, organizatat humanitare, bashkësitë e organizatat fetare dhe organizatat sindikale, - a mund të konsiderohet ndalim ofrimi i ndihmës materiale për partitë, si p.sh. trajnime, festa dhe aktivitete fetare, aktivitete sindikale, etj? Cili është institucioni që monitoron, vlerëson dhe kategorizon qartësisht kufijtë midis lejimit dhe moslejimit?
- d) Lidhur me mbështetjen nga shtetas, qeveri apo firma të huaja: cili është mekanizmi që garanton këtë ndalim në aktivitetin që partitë organizojnë me diasporën jashtë vendit? KQZ nuk ka mekanizma as prezencë, as monitorim jashtë territorit. A ofron ligji garanci se shtete ose shtetas të huaj të mund të pamundësohen të mbështetësin parti që kanë fokus minoritetet dhe pakicat, për të cilat shteti shqiptar nuk ka mekanizma reale monitorimi dhe parandalimi. A quhen të huaj edhe Kosova dhe shtetasit e saj?
- e) Problematika mbetet shumë komplekse: A përfshihen në ndalime edhe kompanitë telefonike, të internetit, të TV, apo ato që kanë akses në mediat sociale, por që kanë burime financimi shtete, fondacione ose qytetarë të huaj? Si monitorohen? Si garantohet zbatimi real i ligjit? Cila është korniza ligjore brenda BE-së që duhet aplikuar edhe në Shqipëri?
- f) Lidhur me kufizimin për shtetas të dënuar për vepra penale në fushën e korrupsionit, pastrimit të parave, krimit të organizuar, trafikimit të lëndëve narkotike ose krime zgjedhore. A ka shteti shqiptar një databasë të tillë nga 1991? Në çfarë periudhe kohore shtrihet kufizimi? Po nëse financimi të bëhet indirekt, nga një individ me rekorde të pastra, por me burime financiare nga kategori të mësipërme? Cilat janë mekanizmat monitorues dhe garantues se ky kufizim do të jetësohet?!
- g) Pika 2 e nenit 7: lejohen dhurata e ndihma nga organizime simotra jashtë, ndërkohë që më lart kishte kufizime edhe për këto kategori. Cili institucion ka përgjegjësinë dhe aftësinë të

gjykojë nëse ndihma të tilla janë “për respektimin e të drejtave të njeriut, nxitjen e barazisë gjinore, demokratizimin, etj” dhe vetë “etj” është evazive në interpretim.

- h) Pika 3 e nenit 7 ia ngarkon zgjidhjen KQZ dhe bashkëpunimit me institucionet respektive, ndërkohë që fusha e përgjegjësisë së pjesës më të madhe të tyre, përfshirë KQZ, Prokuroria, etj, etj, rregullohet me ligje organike, të cilat kanë prioritet mbi ligjin për financimin e partive politike, i cili kalon me shumicë të thjeshtë parlamentare.

Rekomandimi i ISP në këtë rast është riformulimi i nenit 7 sipas praktikave të mira (p.sh. gjermane dhe kroate), duke futur norma, kufizime dhe rregulla të identifikueshme, të zbatueshme, të monitorueshme dhe afatgjata. KQZ mund të ketë kompetencën për ndërhyrje plotësuese, por një ligj nuk është rregullor, për më tepër, deklarative, që bëhet në funksion afatshkurtër kohor. Neni ka nevojë për harmoni midis kategorizimeve dhe modeli më i mirë referues mbetet përsëri modeli gjerman (në pjesën perëndimore, meqenëse kemi marrë dhe modelin gjerman për partitë në kushtetutë, si dhe modeli kroat ose slloven në rajonin tonë, si modele më të suksesshme).

- VI. **Neni 9.** Kufizime në përdorimin e pasurisë. *Partitë politike mund t'i përdorin pasuritë dhe mjediset e tyre për veprimtari ekonomiko-shoqërore të karakterit të botimeve, shtypshkrimeve, shërbimeve apo dhënies me qira, sipas legjislacionit në fuqi.*

Koment dhe rekomandim: Vlerësojmë se shprehja “sipas legjislacionit në fuqi” nuk mjafton për të kuptuar sesi janë përdorur pasuritë dhe mjediset nga ana e partive, për më tepër kur dhënia me qira është aktivitet i ndryshëm nga botimet, dhe se partitë mund të përdorin këtë nen për të siguruar të ardhura ekstra të justifikuar përmes “botimeve, shtypshkrimeve, shërbimeve apo dhënies me qira”. Përderisa ligji ka ndërhyrë në detaje të aktivitetit të partive, duhej të kishte edhe një prag limit i të ardhurave që vijnë nga këto aktivitete.

- VII. **Neni 9. Modalitetet për financimin e partisë politike**

Ky nen shpjegon pjesën ekzekutive të deklarimeve: regjistrimi në regjistrat e partive (që nuk janë publikë), nënshkrim deklaratave për dhënien e kontributeve (që nuk janë publikë), llogari bankare të dedikuara (gjendja e saj nuk është publikë), pragu 50 mijë ALL për deklaram bankar, etj.

Koment dhe rekomandim:

- a) Së pari, terminologjia ka nevojë për rishikim. Terma “*si rregull*” duhen evituar nga një ligj. Ligji vetëm është rregull, jo alternativ.
- b) Së dyti, përjashtimi i anëtarësisë nga detyrimi për kontribute përmes transaksioneve bankare përbën **diskriminim dhe pabarazi në deklarime**. Nuk mundet që një parti kuotat t'i ketë informale dhe burimet e tjera formale. Çdo qytetar që bën deklaram vjetor detyrohet të ofrojë të dhëna të detajuara për shpenzimet dhe të ardhurat, anëtarët e partive trajtohen në këtë rast, “qytetarë të ndryshëm” me privilegj për të vepruar “*cash*” jashtë sistemit bankar. Për sa kohë

KQZ dhe as shteti nuk ka mekanizëm verifikimi të saktë të regjistrimit të anëtarëve të partive, lënia e kësaj hapësire përbën mekanizëm të mundshëm abuzimi.

- c) Së treti, detyrimi i pikës 5 për pragun 50 mijë ALL përmes sistemit bankar bie ndesh me kuotat e anëtarësisë, të cilat të paguara në një datë të vetme mund të jenë mbi këtë vlerë dhe nuk kërkohet të bëhen në bankë. Në këtë rast duhej shtuar, “dhurimi në të holla dhe forma të tjera” sepse mund të jetë dhuratë në mall dhe forma të tjera alternative me vlerë të njëjta mbështetëse për një parti politike.
- d) Së katërti, pika 6, “pa vullnetin për pranimin e saj” përbën më shumë një dispozitë alibi për partitë nëse gjenden në shkelje sesa një mekanizëm transparence dhe barazie në financim. Nuk ka mekanizëm që provon vullnetin dhe pranimin, nëse shumta financiare hyjnë në llogari ato kanë të njëjtën vlerë dhe pasoja ligjore.

VIII. **Neni 10 Kontributet për subjektet politike**

Koment dhe rekomandim:

- a) Termi “dhurata” është përgjithshëm, i papërcaktuar. A është dhurata e barasvlershme me donacionin financiar në monedhë apo materiale? Një automjet, një zyrë, një sistem kompjuterik, një set pajisjes për postkast, etj, mund të konsiderohen dhurata? Nuk mundet një individ apo një person fizik t’i dhurojë një partie një pajisje mbi këtë vlerë? Si garantohet/verifikohet praktika kur një biznesmen është edhe drejtues partie dhe financon përmes firmës partinë e tij? Ne kemi raste konkrete, një nga individët më të pasur në vend deklaroi 0 kontribute financiare në formularët e KQZ dhe zyrtarisht quhet OK, kur monitorimi në terren nga media, shoqëria civile, faktorët ndërkombëtarë, etj, kanë sjell fakte të shumta financimi në miliona euro në aktivitetet, “bamirësi” elektorale, etj.
- b) Për të jetësuar transparencën sugjerojmë se krahas një pragu të arsyeshëm financiar për shpenzime individuale (kryetarë, anëtarë, kandidatë) të vendoset edhe një mekanizëm kontrolli/sigurie që lejon hetime shteruese në çdo rast denoncimi dhe të dhëne edhe në media, edhe nga vëzhguesit. Deklarimi formal në KQZ nuk është i mjaftueshëm. E drejta e KQZ për hetime nuk është gjithashtu e mjaftueshme, pa u kthyer në detyrim për hetime.
- c) Gjithashtu, tri kategoritë e përmendura në nenin 10 pika 1 përbëjnë përjashtim nga kufizimet e nenit 7, gjë që duhet theksuar. D.m.th., të gjithë individët dhe subjektet që plotësojnë kriteret e nenit 7, duhet ritheksuar nëse vendoset të mbahet ky nen.

IX. **Neni 11 Fondi Publik për mbështetjen e partive politike**

Koment dhe rekomandim:

- a) Formula aktuale e ndarjeve të buxhetit publik për partitë është privilegjues për partitë e mëdha dhe nuk siguron barazi, transparencë dhe as ndërlidhje të votës me financimin. Disa vende të tjera, përfshirë Gjermania, e lidhin financimin me numrin e votave dhe numrin e mandateve, si dhe edhe me përfaqësimin lokal. Sipas legjislacionit tonë, një parti që fiton 61

bashki, por nuk merr asnjë deputet në zgjedhje nuk financohet nga buxheti, ndërkohë që zgjedhjet për kryetarin e bashkisë janë të vetmet zgjedhje direkte në Shqipëri.

- b) Sugjerimi ynë është ndërthurje e numrit të mandateve dhe numrit të votave, duke i dhënë më shumë prioritet këtyre të fundit. Mandatet sigurohen edhe përmes formulave (lista të mbyllura të partive kryesore apo formula në zonë zgjedhore), kurse numri i votave është taksativ, i verifikueshëm dhe e detyron një parti të konkurrojë në zgjedhje.
- c) Akordimi 20% për partitë parlamentare dhe ato mbi 10 mijë vota është gjithashtu diskriminues. Aktualisht kemi *de facto* vetëm 6 parti parlamentare konkurruese, por *de juro* kemi rreth dy herë më shumë, pasi disa parti kanë siguruar mandate përmes hyrjes në koalicion real (me emra realë) dhe informal (me mandate të dhuruara përmes deklarimit formal). Zgjidhja në këtë rast është rekomandimi i dhënë më lart.
- d) Pika e fundit, 10% që i shtohet fondit 70% përbën gjithashtu diskriminim. Sidomos në një vend si Shqipëria ku rezultatet zgjedhore kontestohen.
- e) Pika 4, kufizimi për dorëzim raporti financiar, është deklarativ, kurse pika 5 mund të kalojë në Kolegjin Zgjedhor, gjykata administrative merr shumë kohë, sidomos në periudha paraelektorale.
- f) Pika 6, për kuotë 5% për rininë/gruan në partitë politike ka vlerë kur kemi të bëjmë me parti demokratike funksionale (ligji mbi partitë politike) dhe kur këto struktura kanë të drejtë të kenë llogari të pavarura, duke u shoqëruar me akte monitorimi e kontrolli si për partitë politike. Përndryshe, mbetet bonus deklarativ. KQZ nuk ka as kompetencën, as ekspertizën dhe as mundësinë reale të mbulimit shterues të kësaj përgjegjësie.
- g) Pika 7. Detyrimi për indeksim duhet vendosur në afate të njëjta me indeksimin që KM bën edhe për të gjithë buxhetin shtetëror, - institucionet, administratën, nëpunësit, etj.

X. Neni 12. Personi përgjegjës.

Koment dhe rekomandim:

Ngarkimi me përgjegjësi ligjore i personit përgjegjës për financat në partitë politike nuk mendojmë se është zgjidhje dhe përputhet me peshën reale që këta funksionarë kanë në partitë politike. Sipas rregulloreve të brendshme të partive buxheti hartohet nën drejtimin e sekretarit të Përgjithshëm ose një funksionari tjetër të lartë, ndaj edhe ligji duhet të ngarkojë me përgjegjësi zyrtarin më të lartë që ngarkohet me këtë detyrë në partitë politike, siç *de facto* është cituar edhe një nen më poshtë. Zyrtarët e financës janë teknikë, jo vendimmarrës dhe nuk kanë as votë, as mundësi ndikimi brenda partive të tyre edhe lidhur me çështjet e buxhetit dhe transparencës financiare.

XI. **Neni 13. Raportimi financiar**

Koment dhe rekomandim:

- a) Afati i deklarimit 31 mars, është OK.
- b) Pika 4. Dorëzimi i dy raporteve (vjetor dhe zgjedhor) mendojmë se nuk qëndron. Raporti financiar i fushatës duhet dorëzuar pas fushatës (menjëherë) dhe gjatë fushatës (para ditës së votimit). Kjo kërkon rregullim e ndryshme në Kodin Zgjedhor. Çdo vend referues në BE i jep prioritet deklarimeve gjatë fushatës dhe menjëherë pas saj, jo në një periudhë kaq të gjatë të shkëputur sic theksohet në nenin 13. Nëse kjo aplikohet, deklarimi i fushatës bëhet formal.
- c) Pika 5. Sugjerime një ndryshim thelbësor: sapo partitë dorëzojnë raportet, KQZ duhet t'i publikojë ato. Publikimi nuk ndërvarret nga raporti i ekspertëve kontabël. Përmes pikës 5 afati shtohet më 31 prill, kur KQZ raportin vjetor në parlament e ka dorëzuar tashmë me 31 mars, pjesë e të cilës duhet të jetë edhe çështja e financimeve.

XII. **Neni 14. Tatimi i të ardhurave të subjekteve politike**

Koment dhe rekomandim:

Sugjerojmë se duhet specifikuar termi “nuk tatohen”. Nëse një parti me mbi 100 mijë anëtarë siguron miliona përmes kontributit të anëtarëve krijohet diskriminim dhe pabarazi me praktikën e tjera të kontributeve në shoqëri, u jep anëtarëve të partive mbrojtje dhe vetë partive një privilegj ekstra.

XIII. **Neni 15. Kontrolli i brendshëm.**

Koment dhe rekomandim:

- a) Ky nen hyn në organizimin e partive politike, detyrë e ligjit mbi partitë politike. Detyrimi mund të vendoset te ligji i partive politike. Nëse nuk është aty kemi dy ligje që kundërshtojnë njëra tjetrën dhe krijojnë hapësirë për interpretim/abuzim.
- b) Pika 2, u jep të drejtë anëtarëve të partive të informohen për të ardhurat dhe shpenzimet, gjë që futet në të drejtat e statuteve të vetë partive. Kjo nuk sjell risi dhe nuk zgjidh asgjë. Një rekomandim reformator do të ishte detyrimi i partive për të aplikuar aksesin për të gjitha subjektet që monitorojnë proceset zgjedhore dhe partitë politike (media, shoqëri civile, etj) në akordancë me ligjin mbi të drejtën e informimit. Logjika është e përmbytur: qytetarët paguajnë nga fondi publik për partitë, ata (kontribuuesit) nuk kanë të drejtë informimi, por anëtarët e partive (përfituesit) kanë të drejtë informimi!

XIV. **Neni 16. Moaspagimi i detyrimeve**

Koment dhe rekomandim:

Neni 16, pika 2, mund të shndërrohet në penalizim për partitë e vogla dhe të reja politike, nëse vendimmarrja e KQZ vjen në periudha parazgjedhore. Duhet ndryshuar dispozita që penaliteti financiar të mos krijojë hapësirë abuzimi për penalitet politik, për më tepër kur edhe më lart, parashikohet ndjekja e vendimit të KQZ në gjykatat administrative, gjë që kërkon shumë më tepër kohë.

XV. **Neni 17. Kontrolli financiar.**

Koment dhe rekomandim:

- a) Ndryshimet e vogla të bëra lidhur me rolin e ekspertëve janë pozitive por të pamjaftueshme. Sugjerimi ynë ka qenë e mbetet ushtrimi i kontrollit nga një strukturë më solide, më e pavarur dhe më funksionale, si Kontrolli i Lartë i Shtetit për pjesën buxhetore, si dhe nga një instrument i pavarur sipas praktikave në disa vende të BE-së. Ekspertët kontabël të KQZ përgjatë viteve nuk kanë prodhuar pothuajse asgjë të rëndësishme në raportimet mbi financat e partive, ndaj mbetet një mekanizëm i brishtë, jo funksional dhe që nuk siguron transparencë e besim publik.
- b) Pika 5, e drejta e KQZ për verifikim direkt, me kërkesë ose kryesisht, ka të bëjë me administratën e KQZ apo strukturat e KQZ-së? Si garantohet aplikimi i “dhe çdo informacion tjetër për financimin për të cilin vihet në dijeni”? Përmes medias? Denoncimeve? Adresim në KQZ? Gjatë gjitha mandatit 4 vjeçar të parlamentit? Sa zgjat afati i verifikimeve?
- c) Pika 6 për publikimin pas 30 ditëve është përsëritur në nenet më lart. Për verifikimin, nëse afati futet brenda 30 ditëve është OK.
- d) Pika 8, KQZ kur ka dyshime dërgon kopje të raportit PP, DPTT apo DPPPP. Dërgimi nuk zgjidh asgjë, komunikimi me tatimet dhe DPPPP është pjesë e hetimit/verifikimit, kurse në prokurori dërgohet kallëzim, jo informacion. Dispozita duhet rishikuar dhe të bëhet funksionale.
- e) Neni 9. Nëse raporti vjetor i KQZ shkon në Kuvend në mars 2026, p.sh., i takon të bëjë raportim për financat për periudhën 2024, sepse për periudhën 2025 raportimi i partive gjithashtu parashikohet më lart të ndodh në mars 2026?! Datat duhet rakorduar që raportimi të jetë funksional dhe bashkëkohor.

XVI. **Neni 18. Publikimi i i të dhënave nga partitë e përfaqësuara në Kuvend**

Koment dhe rekomandim:

- a) Përse vetëm partitë e përfaqësuar në Kuvend? Do të duhej të ishin të gjitha partitë që kanë qenë subjekte zgjedhore në periudhën midis raportimeve, ose së paku, partitë që përfitojnë fonde publike nga rezultatet e mëparshme elektorale.
- b) Pika a) detyrimi për publikim në faqen zyrtare në internet. Vetëm 3-4 partitë kryesore kanë faqe interneti, shumica e partive aktuale parlamentare nuk kanë faqe të tillë. Si mund të jetësohet ky kriter nëse partinë nuk kanë faqe? Përgjigjia është e thjeshtë, - ato që kanë faqe duhet ti publikojnë, por ndërkohë KQZ duhet të publikojë të gjitha raportet e partive me ose pa faqe interneti. Afati në dhjetor mbetet i diskutueshëm kur mund të ketë shpenzime në ditët e fundit të dhjetorit, - afati 15 janar të vitit pasues është më efektiv.
- c) Pika b është risi, është pozitive, por duhet siguruar sesi realisht të publikohen, që partitë të kenë faqe online ose/dhe ta bëj KQZ, si dhe në dy rastet që aksesit të sigurohet për një periudhë të gjatë.
- d) Vendosja e detyrimit 3 vjet është diskriminuese me parimin e njëjtë dhe vjen në kontrast me vetë mandatin e legjislativës. Për OJF-të afati është 7 vjet, e njëjta praktikë duhet ndjekur edhe për partitë.

XVII. **Neni 19. Organi përgjegjës për financimin e partive.**

Koment dhe rekomandim:

ISP mbështet kalimin e shumicës së këtyre kompetencave te Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), për shkak edhe të detyrimit të tij kushtetues për fondet publike. Nëse do të vijohet me KQZ duhen specifikime konkrete dhe ndryshime thelbësore. Garancia e ofruar në pikën 3, krijimi i një strukture përgjegjëse, nuk zgjidh asgjë për sa kohë është strukturë varësie në KQZ, pa vendimmarrje dhe me punonjës të emëruar ose zgjedhur nga organi epror, pra një zyrë tjetër e administratës publike. Kjo strukturë nëse ruhet, duhet të ketë status pavarësie dhe garanci nga ndërhyrjet politike edhe brenda vetë KQZ-së, si dhe akses më të madh për vendimmarrje.

XVIII. **Neni 20. Masa lehtësuese.**

Koment dhe rekomandim:

- a) Pika a). Dispozita lidhur me mjetet e informimit nuk ka vend në këtë ligj, duhet të jetë te Kodi Zgjedhor.
- b) Pika b). Ky është një nen që vjen nga periudha e fillimeve të tranzicionit, tashmë jashtë kohës dhe logjikës së konkurrencës, transparencës dhe llogaridhënies. Qyteti/shteti paguan miliona për fondet vjetore të partive, dhe përveç kësaj, iu krijon atyre privilegje ekstra, zyra falas në 61

bashki, madje në qendër të qyteteve?! Edhe nëse ky privilegj imponohet nga veto/konsensusi në Komision, çfarë kuptimi ka që shteti të financojë me zyra falas parti që nuk kanë përfaqësim parlamentar në qark ose nuk kanë konkurruar aty, për shkak se kanë siguruar 1 mandat parlamentar në një qark tjetër?

- c) Shqipëria duhet të ndjek modelet e vendeve ku janë kryer edhe vizita studimore nga WFD/NDI, ku partitë vetë me fondet vjetore marrin seli dhe e administrojnë atë, pa privilegje shtetërore. Kjo do i bënte ato më transparente edhe përpara publikut. Praktika si ajo e PSD, e cila ka marrë seli luksoze midis dy ambasadave perëndimore, mbetet një simbolikë domethënëse absurditeti, ndërkohë që ekzistenca në Tiranë e disa zyrave të partive (faktivisht të dhëna me qira informale) të dhëna falas nga shteti, mbetet gjithashtu mekanizëm burokratizimi i partive, krijon diskriminim dhe përbën rast abuziv në raport me standardet e transparencës publike.
- d) Pika c). Një kompetencë e MPB e vitit 2010 për inventarizim nuk është përmbushur asnjëherë. Nuk ka një organ që e detyron MPB apo i kërkon llogari. Ne kemi shkresa korrespondence me të që nuk e kanë as idenë se kjo është përgjegjësi e tyre. E njëjta situatë edhe me Bashkinë Tiranë, p.sh., me të cilën kemi pasur korrespondencë.
- e) Pika 2, nëse nuk zbatohet detyrimi, cili është mekanizmi detyrues për organin përgjegjës? Kush e konstaton, kush e ndjek dhe kush vendos?
- f) Pika 4. Nuk mundet që një subjekt të zgjedh vetë selinë për tu paguar nga shteti. Duhet të ketë kufizime, limite, standarde për këtë.
- g) Në këtë nen gjithashtu koncepti i ministrit përkatës për pronat shtetërore duhet ndërlidhur me kryetarët e bashkive ose prefektit, këta të fundit kanë të drejtë të kenë rol më shumë sesa ministri. Për më tepër kur në pikën 5 përfshihen edhe dy ministra të tjerë, ai i drejtësisë dhe ai i financave? Tre ministra në një nen dhe pastaj Këshilli i Ministrave?! Nëse kjo dispozitë ruhet, duhen vendosur disa linja të vendimmarrjes përkatëse të Këshillit të Ministrave.

XIX. Neni 21. Masa administrative

Koment dhe rekomandim:

- a) ISP nuk mbështet vendosjen shifrore të dënimeve financiare për shkelje, sidomos në kushtet kur kursi i këmbimit ndryshon dhe kur shifrat janë të papërfillshme për individët dhe partitë politike me asete të mëdha financiare. Edhe lënia e hapësirës evazive në nivelin e gjobës është hapësirë abuzimi. Ka parti që do të paguanin me kënaqësi gjobat e vëna në shkëmbim të mosdhënies së informacionit të kërkuar ose mos përmbushjes së detyrimeve për transparencë.

- b) Disa elementë të tjerë, p.sh., pika f, nëse nuk deklarohet sipas ligjit përse gjobitet 30%? E gjithë shifra është në kundërshtim me ligjin dhe e gjithë shifra përbën gjobë. Në pikën g, gjoba për personin përgjegjës 1-3 rroga mujore gjithashtu nuk garanton asgjë.
- c) Midis pikës 1 (fonde të parregullta) dhe pikës 2 (fonde anonime) krijohet disproporcionalitet pasi të dytat kalojnë në llogari të KQZ. Në fakt, duhej kaluar në llogari të shtetit, jo të KQZ dhe parimi duhej të ishte i njëjtë në dy rastet e shkeljeve.
- d) Pika që lidhet me kufizimin, nëse nuk dorëzon dy vjet radhazi raportin, penalizohet për zgjedhjet e radhës, mendojmë se duhej të ishte standardi më proaktiv, - nëse nuk dorëzohet një vit penalizohet për zgjedhjet pasuese. Fjalja “zgjedhjet në vijim” mund të jenë parlamentare, lokale, të pjesshme, etj, pra duhet specifikuar.

XX. Neni 22. Parimet e vendosjes së gjobës.

Koment dhe rekomandim:

Mbeten të paqarta shumica e kritereve të listuara, “*nëse shkelja është kryer në bashkëpunim*”, “*kohëzgjatja dhe rrethi i veprimeve që kanë çuar në kryerjen e shkeljes*”, “*veprimet e partisë politike pas zbulimit të shkeljes*”, “*rreziku që përbën shkelja e kryer*”, etj, etj. Këto rrethana nuk vlejné për qytetarët që penalizohen me gjoba për mosdeklarime ose shkelje ligji, përse duhet të sigurojmë rrethana lehtësuese dhe shumë të interpretueshme për partitë?

XXI. Neni 24. Përdorimi i teknologjisë së informacionit.

Koment dhe rekomandim:

Vlerësojmë se është pozitive rëndësia e transparencës online dhe krijimi i database me të dhëna, me akses publik. Gjithsesi vlerësojmë gjithashtu se p.sh., pika 2, mundësimi i pasqyrimit në kohë reale i çdo transaksioni i të ardhurave që përfiton partia politike mbetet i paqartë, në kohë, për përmbajtjen dhe saktësinë e informacionit. Për më tepër, në tekstin vijues, partitë deklaruese e humbasin detyrimin për publikim online dhe raportim në KQZ!

XXII. Neni 25. Aktet nënligjore

Koment dhe rekomandim:

Sugjerimi është që Komisioni i Reformës të miratojë edhe strukturën (elementët më të rëndësishëm) të akteve nënligjore të pritshme, në mënyrë që VKM të mos krijojë mospërputhje midis ligjit dhe përmbajtjes së tyre, - konsensusi të jetë shterues në të gjitha fazat dhe produktet dhe që të sigurohet se aktet nënligjore nuk krijojnë asnjë dualizëm, mbivendosje ose interpretim ndryshe të dispozitave ligjore.